

Art natyror i zbuluar me vetëdije artistike.

(22 Prill 2013)

Kur shikon këto vepra arti që janë nxjerrë nga druri i prerë, një ndjenjë entuziaste artistike të përshkon. Këto vepra i vlerësoj shumë në disa drejtime, si nga ana ideore ashtu dhe artistike. Një vepër arti mund të ekzistojë kudo, mjafton që artisti përzgjedhës ta ndjejë dhe të fantazojë në përzgjedhje, seleksionim dhe interpretim në kompozimin e veprës të artit në më të mirën e mundshme. Në këtë rast kemi artistin Muhamet Trepci që me inteligjencën e tij, na fut në një botë artistike shumë të gjetur, pa shumë bujë, që sa më shumë ti shikojmë këto vepra aq më shumë zbulon vlera të papërsëritshme.

Druri në vetvete mbart një histori të fshehur ku janë iniciuar shumë momente të vështira dhe të mira të kohës ku kjo pemë u rrit. Por sa e vështirë është ta zbulosh historikun e kësaj peme të inkasuar në brendësi të saj? Kësaj pyetjeje i përgjigjet më së miri artisti me shumë dinjitet nëpërmjet veprave të drunjëta që tanimë janë të kuruara dhe të ekspozuara. Figurativiteti plot fantazi, kompozim, ndryshueshmëri ngjyre, të mbërthejnë fort me orë të tëra dhe për një kohë të gjatë të mbesin në kujtesë si vepra shumë origjinale dhe që ke dëshirë t'i rikthehesh herë pas here.



Kompozim – “Njeriu që mbart një dhimbje të madhe të shkaktuar nga një sekret i jetës së vet”

Këtë dhimbje ai e mbarte si një bërthamë e ruajtur me delikatesë në qendër të figurës. Me anë të një vizatimi shumë elegant të rrjedhshëm dhe me shumë variacion që kalon nga linja delikate në atë të forte, te një materializim formash dhe detajesh shumë të fuqishme që flasin pafundësisht. Në qendër të figurës të fuqishme burrërore dallohet qartë, si në antitezë me të, një figure delikate femërore e stërzgjatur si një nimfë e veshur me mëndafsh nëpërmjet një vizatimi shumë elegant plot emocion. Tek figura gjithpërfshirëse, që thamë më lart, njeriu mister ka një siluetë shumë të fortë e të ashpër që mbron me kujdes nimfën e tij. Kjo siluetë krijohet nga dy anë që janë aq sa të ngjashme aq edhe të ndryshme. Atmosfera të le pa fjalë sepse vetëm një

natyre artist dhe një artist i natyrshëm mund ta bëjë atë zhdërvjelltësi të figurshme të papërsëritshme në llojin e vet.

Në këto vepra arti të drunjta me figura të hiperbolizuara tregohet edhe njëherë që gjetja nuk ka kufinj as njerëzor dhe as natyror, gjë që vërteton shumë thënje të njerëzve të shquar që me zbulimet e tyre në fusha të ndryshme iu kundërvuan një mentaliteti meskin të kohës dhe e bënë atë të ndryshojë në të mirën e saj.

Xheneta Kadillari - Piktore